

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5636
E premte, 23 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Në Maqedoni shënohet Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

VENDIMI I QEVERISË PËR TAKSËN, I DREJTË

F. 6
Skender GASHI



HARADINAJ, MIRËNJOHËS PËR NDIHMËN E KFOR-it PËR OFRIMIN E SIGURISË

DORËZOHET MEDIKAMENTI 'SURFAKTANT' NË KLINIKËN E NEONATOLOGJISË

F. 6

EKONOMI



LUGINA KËRKON PËRJASHTIMIN E BIZNESEVE TË SHQIPTARËVE NGA TAKSA DOGANORE

BQK-ja NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME BANKËN QENDRORE EVROPIANE

F. 8

SPORT

BEQIRI: NË DRENICË SHKOJMË PËR FITORE

GASHI: U REALIZUA NJË ËNDËRR E KAMOTSHME

F. 12



FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI

Qeveria nuk duhet të zbrapset për taksën ndaj Serbisë

**- Vendosja e
reciprocitetit me
Serbinë afron
zgjidhjen e problemeve
mes dy vendeve**

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë se vendimi për rritjen e taksës ndaj mallrave të Serbisë është i drejtë dhe duhet të vlerësohet në kontekstin e obstrukcioneve të vazhdueshme të Serbisë ndaj Kosovës. Ai e ka inkurajuar Qeverinë e Kosovës të mos zbrapset nga ky

vendim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka theksuar se ky vendim duhet ta detyrojë Serbinë të heqë dorë nga politikat destruktive në raport me Kosovën. Sipas tij, nga kjo betejë Kosova nuk duhet të dalë pa përfitime. Murati ka shprehur optimizëm se vendosja e reciprocitetit

me Serbinë do ta afronte zgjidhjen e problemeve në mes të dy vendeve. Ai ka vlerësuar se vendimi për taksën ndaj produkteve serbe është mesazh për Serbinë dhe bashkësinë ndërkombëtare që të fillojnë ta trajtojnë Kosovën dinjitetshëm dhe barabartë me shtetet e tjera

Kosova e vendosur që mos ta shfuqizojë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë

FAQE 9



Opozita kritikon politikën e jashtme

Deputetët e opozitës e kanë akuzuar politikën e jashtme dhe udhëheqësit e saj për dështimin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Sipas tyre, mosanëtarësimi i Kosovës në Interpol është vetëm një nga dështimet e Qeverisë. LDK-ja dhe LV-ja kanë propozuar miratimin e një



rezolute e cila kërkonte dorëheqjen e Qeverisë, por ajo nuk ka arritur t'i marrë votat e nevojshme

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666



Veseli bën homazhe te monumenti i ushtarit të panjohur në Bruksel

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë të enjten homazhe te monumenti i ushtarit të panjohur në Bruksel. Kreu i Kuvendit të Kosovës u shoqërua në

këto homazhe nga atasheu ushtarak i Forcës së Sigurisë së Kosovës që punon në Ambasadën e Kosovës në Belgjikë. Për nder të pranisë së kryeparlamentarit Veseli në këto homazhe, Garda e

Nderit e Mbretërisë së Belgjikës intonoi himnin shtetëror të Kosovës dhe e njoftoi kryeparlamentarin e Kosovës për historikun e monumentit të ushtarit të panjohur.

Përleshje para Kuvendit, policë të plagosur dhe protestues të arrestuar

Protesta e banorëve të zonës së "Astirit", për ta kundërshtuar zgjerimin e Unazës së re, u kthye në një përplasje të fortë me policinë para selisë së parlamentit, me ç'rast policia arrestoi 11 persona, kurse 13 punonjës policie janë të lënduar nga goditje me mjete të forta apo lëndë plasëse



qytete të tjera të vendit. Kryeministri reagoi më pas dhe për ngjarjet e dhunshme gjatë protestës. Përmes një postimi në Twitter ai u shpreh se "dhuna ndaj policëve në emër të paligjshmërisë, s'do tolerohet! U bëj thirrje atyre që kanë dokumente prone a vetëm strehën pa leje: Distancohuni nga zaptuesit profesionistë dhe profesionistët e politikës qorre të shpifjeve e të rrëmujës! Merrni ç'ju jep ligji e largohuni nga rruga", tha Rama. Pas vizitës në spital të policëve të plagosur, zëvendësministri i Brendshëm Sandër Lleshi u shpreh se "është për të ardhur keq, është e papranueshme, është e pakuptueshme, që në një ditë të tillë, krejt normale, të na ndodhë një ngjarje anormale, të goditet Policia e Shtetit

në krye të detyrës. Konstatojmë për fat të keq, se ajo sot është goditur nga qytetarë të papërgjegjshëm, të cilët në shkelje të plotë të ligjit, ngrënë dorën mbi Policinë e Shtetit. Po ashtu Policia është goditur edhe nga përfaqësues të caktuar politikë, të cilët po ashtu në kushtet e papërgjegjshmërisë qytetare dhe politike, inspirojnë dhunë ndaj forcave të Policisë së Shtetit". Lleshi ju drejtua me një thirrje edhe përfaqësuesve politikë të caktuar, të cilët mundohen të krijojnë kapital politik nga një konflikt civil, që të distancohen nga dhuna dhe nga aktet e papërgjegjshme dhe të vihen në mbështetje të Policisë. Për këto zhvillime reagoi me shqetësim dhe presidenti Ilir Meta nga Shkupi ku ndodhej

për vizitë zyrtare. "Meta shpreh keqardhjen më të thellë për aktet e dhunshme të shfaqur gjatë kësaj proteste dhe u bëj thirrje të gjitha palëve të përfshira që të shmangin çdo përplasje dhe të vendosin sa më parë një dialog institucional në mënyrë që ankesat e banorëve të shqyrtohen duke i dhënë një zgjidhje kësaj shtate", theksohet në reagimin e Kreut të Shtetit, duke shtuar se "pasi u njoh me raportimet, se disa efektivë të Policisë së Shtetit dhe protestues paqësorë janë lënduar, presidenti i Republikës, shpreh keqardhjen më të thellë dhe u uron shërim sa më të shpejtë".

Përmes deklaratës Meta dënon aktet e dhunshme dhe u bëj thirrje të gjitha palëve të distancohen menjëherë nga dhuna dhe të bëjnë maksimumin për të shmangur konfliktin dhe gjuhën së forcës së përdorur në këtë çështje, ndërsa kërkon urgjentsisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë për të gjithë qytetarët dhe interesin publik. Kreu i Shtetit i bëri gjithashtu thirrje politikës të tregohet e kujdesshme dhe të japë mesazhe bashkëpunimi e dialogu, ndërkohë që nxitësit e dhunës duhet të izoloohen.

TIRANË, 22 NËNTOR - Policia e Tiranës njoftoi të enjten pasdite se kishte arrestuar 11 persona, pjesëmarrës në protestën e dhunshme përpara parlamentit, kundër projektit për zgjerimin e Unazës së re, në pjesën e njohur si "zona e Astirit", për zbatimin e të cilit parashikohet të prishen rreth 240 ndërtesa banimi dhe shërbimi. Ata akuzohen për veprat penale "Plagosje e rëndë me dashje", "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe në manifestime të paligjshme", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike" si dhe "Goditja për shkak të detyrës". Protesta u kthye në një përplasje të fortë me policinë para selisë së parlamentit. Shashka dhe tymuese të shumta u hodhën drejt oborrit të parlamentit ku ishin rreshtuar forca të shumta të policisë, të cilat sprapsën disa përpjekje të protestuesve për të çarë me forcë kordonin e krijuar prej tyre. Janë 13 punonjës policie të

cilët rezultojnë të lënduar nga goditje me mjete të forta, apo lëndë plasëse. Një prej tyre, një e re 24 vjeçare, ka humbur 4 gishtat e njëjës dorë. Në spital, përfunduan dhe disa nga protestuesit.

Tensioni përpara parlamentit erdhi e u rrit ndërsa në sallë kryeministri Edi Rama duke folur për e zgjerimit të Unazës së re, ishte i prerë në qëndrimin e tij lidhur me zgjidhjen e ofruar për largimin e banorëve që preken. Sipas shifrave zyrtare bëhet fjalë për afro 240 objekte mes të cilave, banesa por dhe mjedise shërbimi. Afro gjysma rezultojnë të jenë ndërtime pa leje dhe në proces legalizimi. Kryeministri deklaroi se për ata që kanë godinat me leje do të bëhet shpronësim i plotë sipas ligjit, ndërsa për banesat pa leje do të ofrohet 3 vjet qira. Rama tha se mes atyre që kanë ndërtime pa leje ka dhe nga ata që rezultojnë të kenë të tilla dhe në zona të tjera të Tiranës apo


Maqedonia insiston për ekstradimin e Gruevskit

SHKUP, 22 NËNTOR - Autoritet në Shkup do të kërkojnë nga Hungaria që të largojnë vendimin për dhënie të azilit ish-kryeministrit maqedonas Nikola Gruevski.

Ministria e Drejtësisë Renata Deskoska tha se Maqedonia do të kërkojë nga Hungaria ekstradimin e Gruevskit. Sipas ministres maqedonase,

autoritet hungareze do të marrin përmes postës elektronike argumentet e Shkupit, pasi që pretendimet e ish-kryeministrit nuk janë të vërteta.

Nikola Gruevski u arratis javën e kaluar nga Maqedonia për t'i shpëtuar burgimit me dy vjet pas akuzave për keqpërdorim të detyrës.



May: Negociatat për Brexitin janë në një çast thelbësor

LONDËR, 22 NËNTOR - Negociatat e Brexitit janë në një çast thelbësor, deklaroi të enjten kryeministria britanike Theresa May para deputetëve, para se të zhvillojë të dielën një samit në

Bruksel me qëllim të miratimit të marrëveshjes së vendosjes së marrëdhënieve të ardhshme. "Negociatat janë aktualisht në një çast kritik", tha May, para se ta përmendë çështjen e

Gjibraltarit, duke garantuar se sovraniteti britanik në këtë territor do të mbahet.

Disa çaste më parë Theresa May deklaroi nga selia e kryeministrit, se marrëveshja me

Bashkimin Evropian për çështjen Brexit është marrëveshja e duhur për Britaninë e Madhe dhe se ajo reflekton vullnetin e shumicës prej 52 % që votuan për ta lënë unionin.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancën e jashtëzakonshme parlamentare për politikën e jashtme

Opozita kritikon politikën e jashtme



Deputetët e opozitës e kanë akuzuar politikën e jashtme dhe udhëheqësit e saj për dështimin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol. Sipas tyre, mosanëtarësimi i Kosovës në Interpol është vetëm një nga dështimet e Qeverisë. LDK-ja dhe LV-ja kanë propozuar miratimin e një rezolute e cila kërkonte dorëheqjen e Qeverisë, por ajo nuk ka arritur t'i marrë votat e nevojshme

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Subjektet opozitare kanë kritikuar politikën e jashtme të Kosovës dhe udhëheqësit e saj. Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare të thirrur nga opozita për të diskutuar për politikën e jashtme, deputetët e partive opozitare kanë deklaruar se këtë vit Kosova ka shënuar vetëm një njohje ndërkombëtare dhe nuk ka arritur asnjë anëtarësim përmbajtësor në ndonjë organizatë. Sipas tyre, dështimi më i madh i politikës së jashtme, të udhëhequr nga presidenti Hashim Thaçi dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ishte mosanëtarësimi i Kosovës në Interpol. Deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, ka thënë se Qeveria dhe presidenti i Kosovës kanë arritur që brenda një viti ta shkatërrojnë orientimin gjeostrategjik që ka mbajtur për vite me radhë Kosova. Sipas saj, ideja e ndryshimit të kufirit ka sjellë

rikthimin e debateve për statusin e Kosovës. "Nga presidenti i vendit, kur kërkohet të mos nënshkruajë asgjë në raport me shtetet e tjera pa bekimin e Gjermanisë, ai mburret se, pavarësisht prej bekimit të Gjermanisë, e ka atë të Rusisë. Kosova ka shënuar vetëm një njohje ndërkombëtare, nga Barbadosi, gjatë këtij viti dhe asnjë anëtarësim përmbajtësor në ndonjë organizatë të rëndësishme. Ka dështuar të kapitalizojë ndonjë sukses të vetëm në politikë të jashtme dhe dështimi më eklatant ishte ky i Interpolit", ka thënë Osmani.

Ajo ka kërkuar që Kuvendi të miratojë një rezolutë me të cilën kërkohet tërheqja e Qeverisë së Kosovës dhe hapja e rrugës për institucione të reja. "Qeveria e Kosovës të japë dorëheqje për t'i hapur rrugë formimit të institucioneve të reja të cilat duhet ta konsolidojnë dhe ta forcojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, në përputhje me orientimet

gjeopolitike për integritet euroatlantike", është shprehur ajo.

Kritik ndaj presidentit Thaçi dhe ministrit Pacolli ka qenë edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Sipas tij, përfaqësuesit e politikës së jashtme nuk kanë kredibilitet që ta përfaqësojnë vendin në arenën ndërkombëtare. "Sa më shumë llobojnë këta, aq më keq bëhet. Qysh moti na kanë premtuar njohje nga Serbia dhe anëtarësim e askund s'jemi. Kjo nuk ka ndodhur, sepse politika e jashtme është edhe politikë e brendshme. Miliona janë dhënë për lobim e për anëtarësim në Organizata Ndërkombëtare, ndërkaq që pagat janë shumë të ulëta. Përfaqësuesit e politikës së jashtme janë pa dije. Ata llobojnë si t'ua dojë mendja. Nuk mund të lobosh me qasje biznesmeni për Interpol", ka thënë Kurti.

Ndërsa deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dukagjin Gorani, ka theksuar se politika e jashtme është pasqyrë e gjendjes së brendshme të Kosovës. "Kurrë s'e kuptoam e as që duam ta kuptojmë, se të gjitha politikat, e më së shumti ajo e jashtme, janë pasqyrë e gjendjes së brendshme. Andaj, gjithë këto vite të shpenzuara në gënjime elektorale të vetes, po na hakmerren sot një nga një. Jemi më të izoluar se kurrë, pavarësisht prej të gjitha sukseseve tona diplomatike, jemi më të mospërfillur se kurrë pavarësisht prej të gjitha

fotografive me liderë botërorë. Jemi më të vetmuar se kurrë, edhe pse tash e sa muaj i kemi qitë në shitje kufijtë e shtetit dhe tokat e popullit", ka thënë Gorani.

Pozita mbron politikën e jashtme

Opozita nuk është pajtuar me konstatimet e subjekteve opozitare. Kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se politika e jashtme i ka mangësitë e veta, por ai e ka ftuar Kuvendin t'i nxjerrë temat në të cilat duhet të fokusohet diplomacia. "Politika e jashtme i ka të metat e veta dhe ka vend për kritikë. Besoj se kjo është e drejtë të thuhet. Dëshira do të ishte që në këtë seancë t'i nxjerrim detyrat dhe obligimet që janë me më shumë rëndësi dhe të japim rekomandime sa më të qarta", ka thënë Haradinaj. Deputetja e PDK-së, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, ka thënë se Kosova po përballet me sfida të ndryshme, duke shtuar se, pavarësisht prej vështirësive, Kosova po shënon përparim në këtë rrafsh. "Takimet e nivelit të lartë që nga Departamenti i Shtetit e deri tek ekzekutivi amerikan, por edhe shumë takime të tjera me delegacione nga e gjithë bota, bënë që Kosova të marrë mbështetje për proceset në të cilat po kalon, siç është shndërrimi i FSK-së në ushtri, bisedimet me Serbinë lidhur me

arritjen e marrëveshjes finale mes dy shteteve e të tjera. Samiti i Frankofonisë, i mbajtur në Jervan të Armenisë, ishte një sukses i pakontestuar për Kosovën, me ç'rast nga vëzhguese, Kosova u bë anëtare e asociuar", ka thënë Thaçi-Drăgusha.

Kurse deputeti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Islam Pacolli, ka thënë se kritikën ndaj politikës së jashtme nga partitë e tjera janë të pandershme. Sipas tij, për diplomacinë e Kosovës në këto vite përgjegjës ka qenë i gjithë spektri politik, duke shtuar se çdo subjekt politik ka dërguar për ambasadorë dhe zyrtarë të tyre në vendet që e kanë njohur Kosovën. "Ministria e Punëve të Jashtme nuk është kryekëput përgjegjëse për anëtarësim në Interpol. Çdokush që ka folur këtu dhe ata që nuk kanë folur e dinë se ku janë problemet. Çdokush e di se kush i ka dërguar ambasadorët e Kosovës", ka thënë ai.

Në fund të debatit parlamentar, LDK-ja dhe LV-ja kanë propozuar miratimin e një rezolute e cila kërkonte dorëheqjen e Qeverisë dhe hapjen e rrugës për institucionet e reja. Por, kjo rezolutë nuk ka arritur t'i marrë votat e nevojshme të deputetëve. Ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, nuk ka marrë pjesë në këtë seancë dhe ka kërkuar nga Kuvendi që kjo seancë të shtyhet për një ditë tjetër për shkak të agjendës së tij.

Flet për "Epokën e re", Valon Murati

Qeveria nuk duhet të zmbrap



- Vendosja e reciprocitetit me Serbinë afron zgjidhjen e problemeve mes dy vendeve

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë se vendimi për rritjen e taksës ndaj mallrave të Serbisë është i drejtë dhe duhet të vlerësohet në kontekstin e obstrukcioneve të vazhdueshme të Serbisë ndaj Kosovës. Ai e ka inkurajuar Qeverinë e Kosovës të mos zmbropset nga ky vendim. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka theksuar se ky vendim duhet ta detyrojë Serbinë të heqë dorë nga politikat destruktive në raport me Kosovën. Sipas tij, nga kjo betejë Kosova nuk duhet të dalë pa përfitime. Murati ka shprehur optimizëm se vendosja e reciprocitetit me Serbinë do ta afronte zgjidhjen e problemeve në mes të dy vendeve. Ai ka vlerësuar se vendimi për taksën ndaj produkteve serbe është mesazh për Serbinë dhe bashkësinë ndërkombëtare që të fillojnë ta trajtojnë Kosovën dinjitetshëm dhe barabartë me shtetet e tjera

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 NËNTOR -

"Epoka e re": Z. Murati, si e komentoni vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e taksës doganore ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës nga 10 për qind në 100 për qind?

Murati: Vendimi është i drejtë dhe duhet të vlerësohet në kontekstin e obstrukcioneve të vazhdueshme të Serbisë ndaj Kosovës. Ajo nuk lë gur pa lëvizur për ta dëmtuar Kosovën, qoftë duke e minuar stabilitetin e brendshëm me Listën Serbe, qoftë duke lobuar kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Vazhdon ta shfrytëzojë tregun e

Kosovës për ta fuqizuar jo vetëm ekonominë e vet, por edhe për ta financuar tërë punën kundër Kosovës që bën si dhe diskriminimin e shqiptarëve në Kosovën Lindore. Nuk bën t'i lejohet Serbisë që ajo të pranojë të bashkëpunojë me Kosovën vetëm në fushat që i konvenojnë asaj, ndërsa ta minojë shtetin e Kosovës në të gjitha fushat ku ajo mendon se po fuqizohet sovraniteti i Kosovës. Serbia dëshiron ta respektojë CEFTA-n, se përfiton nga Kosova, ndërsa nuk realizon marrëveshjen për energjinë, sepse forcohen Kosova dhe Shqipëria në planin e pavarësimit energjetik. Vërtet këto masa mund të duken se janë kundër frymës së integriteteve evropiane e rajonale, kundër tregut të lirë etj. por, së pari, të vlerësojmë se në çfarë fryme vazhdon të silltet Serbia me Kosovën dhe shqiptarët në Kosovën Lindore. Në frymën evropiane? Jo, aspak! Serbia vazhdon të jetë vetëm në formën e saj evropiane dhe demokratike, ndërsa në përmbajtjen e saj është thellë

nacional-shoviniste dhe neo-kolonialiste në raport me Kosovën dhe shqiptarët. Andaj reciprociteti me Serbinë duhet të jetë i plotë dhe i thellë. Sado sakrificat që mund të na kërkohen, ne si qytetarë do t'i përballojmë. Nga kjo betejë nuk duhet të dalim pa përfitime. Mbi të gjitha, besoj se kjo situatë tensioni do t'i krijojë kushtet që të gjithë t'i qasen shumë më seriozisht zgjidhjes politike të kontestit shqiptaro-serb, në mënyrë që pastaj të ndërtohen raporte më normale dhe më të barabarta në mes të dy vendeve dhe popujve tanë.

"Epoka e re": Cilat janë të mirat dhe pasojat që mund t'i sjellë ky vendim?

Murati: E mira e madhe është se Serbisë po i dërgohet një mesazh, por jo vetëm asaj, por edhe bashkësisë ndërkombëtare, që duhet të fillojë ta trajtojë Kosovën me dinjitet dhe si partnere e barabartë. E dyta, mund të nxisë një atmosferë më të mirë për prodhimet vendore në mënyrë që të

set për taksën ndaj Serbisë



të mobilizohen dhe t'u ndihmojnë bizneseve për gjetjen e rrugëve alternative për lëndë të parë, në anën tjetër, nëse është nevoja përkohësisht edhe t'i subvencionojë prodhuesit e produkteve bazike dhe të atyre që janë me interes për ekonominë e Kosovës. Nëse këto masa nënkuptojnë shkelje të rënda të CEFTA-s, atëherë ndoshta është mirë të mendohet që përkohësisht Kosova ta suspendojë anëtarësinë e saj në këtë organizatë. Të gjithëve duhet t'ia bëjmë me dije seriozitetin e situatës në raport me dëmet që po na i shkakton Serbia.

"Epoka e re": Përveç reagimeve të Serbisë dhe Bosnjës, ka pasur reagime të ashpra edhe nga zyrtarët e lartë të Bashkimit Evropian. Si i keni parë reagimet e Mogherinit dhe Hahnit të cilët kanë kërkuar të shfuqizohet ky vendim?

Murati: Reagimet e BE-së janë të pritshme, sepse ata çdoherë i frikësohen destabilizimit rajonal. Gjithashtu, duke qenë se tregtia e lirë është një prej shtyllave të krijimit dhe funksionimit të BE-së, ajo medoemos do të reagojë në këtë drejtim. Por, BE-së i duhet bërë e qartë se destabilizues i Ballkanit vazhdon të jetë Serbia dhe ndaj saj duhet të shtohet presioni në mënyrë që të zgjidhet me bisedime politike kontesti në mes të dy vendeve. Unë jam optimist se kjo masë dhe masat e tjera që do të duhej Qeveria të ndërmarë në fushën e vendosjes së reciprocitetit me Serbinë, vetëm sa do ta afrojnë zgjidhjen e problemeve në mes të dy vendeve.

"Epoka e re": Sa mund t'i bëjë ballë presionit të BE-së Qeveria e Kosovës për këtë çështje? Ka rrezik që të ketë kthim prapa?

Murati: Kjo është një çështje që i mbetet Qeverisë. Ne e inkurajojmë të mos zbrapset, së paku pa e detyruar Serbinë të zbrapset nga politikat destruktive në raport me Kosovën dhe të mos e trajtojë Kosovën vetëm si një treg të garantuar të cilin duhet ta mjetë pa mëshirë.

"Epoka e re": Nëse Kosova arrin ta mbajë në fuqi taksën prej 100 përqindësh, cilët janë hapat që duhen ndjekur?

Murati: Në raport me Serbinë duhet të vendoset reciprociteti në çdo fushë dhe të kërkohet që të drejta të njëjta që garanton Kosova për serbët, të garantohen edhe për shqiptarët në Serbi,

përfshirë vendet e garantuara dhe të drejtën e vetos për ndryshime kushtetuese dhe ligjore. Ndërsa sa iu përket masave të brendshme, përveç atyre që i theksova më lart, duhet të punojë shumë seriozisht për krijimin e një ambienti ku do të sundojë ligji, ku do të luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar në mënyrë që edhe me këto mekanizma të ndihmohen ndërmarrësit aktualë dhe ata potencialë.

"Epoka e re": Gjithashtu, Serbia ka paralajmëruar se nuk mund të vazhdohet dialogu me Kosovën pa u hequr taksa. A do të duhej që Kosova të marrë vendim që përkohësisht ta

ndërpresë edhe dialogun?

Murati: Pavarësisht prej taksës, ky dialog është dashur të përfundojë moti sepse është ndërtuar në premisa të gabuara. Kosova përfundimisht nuk duhet të bëjë dialog me Serbinë ku diskutohet vetëm për interesat e Serbisë dhe të serbëve në Kosovë. Kjo ka qenë një qasje e gabuar prej fillimit. Në dialogun e deritanishëm kryesisht janë akomoduar interesat e Serbisë në Kosovë dhe të serbëve të Kosovës, përderisa edhe nëse është arritur diçka në të mirë të Kosovës, apo shqiptarëve në Kosovën Lindore, ato marrëveshje ose nuk janë realizuar asnjëherë, ose realizohen me vështirësi. Ne me Serbinë kemi probleme

politike, andaj duhet të përgatitemi mirë që të realizojmë një dialog të mirëfillt politik. LB-ja, duke u bazuar në platformën e vet, është e bindur se zgjidhja më e mirë është që të vendoset parimi i reciprocitetit në të drejta në mes të shqiptarëve të tri komunave të Kosovës Lindore me ato të serbëve të Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit, parim i cili si zgjidhje logjike do të kishte riedefinimin e kufijve në mes të dy popujve dhe vendeve, duke u bazuar në vullnetin e tyre në këto pjesë për të cilat i përmenda. Kur t'i zgjidhim problemet politike atëherë edhe këto teknikat (nëse ka diçka teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë) do të zgjidheshin automatikisht.

Bursa për të gjithë studentët me nevoja të veçanta

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije se do të ketë bursa për të gjithë studentët me nevoja të veçanta. Ai ka treguar se këta studentë mund të aplikojnë për bursë nga të gjitha fushat e studimit që organizohen në universitetet publike në Kosovë. Lidhur me konkursin e publikuar më 19 nëntor për

ndarjen e bursave për studentët e universiteteve publike për vitin akademik 2018-2019, ministri Bytyqi ka dhënë këtë sqarim: "Si ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, në lidhje me bursat në fjalë, kam marrë vendim që, fushat e studimit të përcaktuara në konkurs të mos vlejnjë për studentët me nevoja të veçanta. Pra, këta studentë mund të aplikojnë

për bursë nga të gjitha fushat e studimit që organizohen në universitetet publike në Kosovë. Gjithashtu, bazuar në Udhëzimin Administrativ, nr. 14/2017, të datës 06.12.2017, të kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs, pika 1.2 deri 1.5, nuk vlejnjë për studentët me nevoja të veçanta", ka deklaruar në sqarimin e tij ministri Bytyqi.



fillojmë të krijojmë më shumë besim në to, por edhe të krijojmë hapësirë për ndërmarrësit aktualë, edhe ata të rinj që të hyjnë në projekte ekonomike prodhuese, në lëmenjtë në të cilët deri më tani nuk kemi prodhim (e ato janë të shumta). E treta, krijon kushte që tregtarët tanë të fillojnë të mendojnë që të krijojnë edhe rrugë të tjera importi, fillimisht nga Shqipëria, pastaj edhe nga vendet e tjera. Në anën tjetër, duhet të jemi të vetëdijshëm se kjo betejë nuk do të jetë e lehtë as për Kosovën dhe as për qytetarët e saj. Çmimet e produkteve bazike mund të rriten, po ashtu mund të ketë efekt negativ në prodhuesit vendorë të cilët lëndën e parë e marrin në Serbi. Mirëpo të gjithë duhet t'i shtrëngojmë dhëmbët, të sakrifikojmë e të mos zbrapsemi nga kjo betejë. Nuk ka kuptim që ne në pëllëmbë dore t'ia dhurojmë Serbisë nga 450 milionë euro në vit. Në këtë situatë Qeveria, së bashku me të gjithë mekanizmat shtetërorë dhe me asociacionet e bizneseve, duhet

Berisha me senatoren amerikane: FSK-ja do të mbetet forcë e besueshme

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, në Halifaks ka zhvilluar një takim me senatoren amerikane, njëherësh anëtare e Komitetit të Senatit për Forcat e Armatosura, Jeanne Shaheen. Në takim, ministri Berisha e njoftoi senatoren Shaheen për procesin e transi-


cionit të FSK-së, të arriturat e deritanishme dhe sfidat e këtij procesi.

Ministri Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i kanë shprehur shqetësimin e tyre senatores Shaheen lidhur për fushatën kërcënuese që po u bëhet nga jashtë pjesëtarëve të komunitetit

serb, të cilët po dekurajohen që të shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në fund të takimit, ministri Berisha e ka siguruar senatoren se FSK-ja do të mbetet forcë e besueshme, e përkushtuar dhe e gatshme në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës, si dhe në shërbim të paqes dhe sigurisë në vend, rajon dhe më gjerë.



Vendimi i Qeverisë për taksën, i drejtë



Skender GASHI

Qeveria e Kosovës mori vendim që të vendoset masa prej 100 përqindësh ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, përjashtuar brendet ndërkombëtare. Pas këtij vendimi, është koha që klasa politike të zgjohet njëherë e përgjithmonë, në mënyrë që të jemi unikë si shqiptarë dhe si komb. T'i tregojmë Ballkanit e Evropës se mjaft më na keni copëtuar në të gjitha luftërat që janë zhvilluar në Ballkan, Evropë dhe Botë.

Deri kur ne si popull duhet t'i gjuhëzohemi Serbisë dhe Evropës. Ne në të gjitha luftërat nuk kemi qenë okupatorë ndaj as një shteti, prandaj Evropa u ka borxh shqiptarëve që t'ua japë të drejtat e veta si të gjithë popujve të tjerë në Ballkan dhe Evropë.

Zonja Federica Mogherini, ju lutem implementojeni drejtësinë edhe te ne, sepse jemi një popull liridashës dhe jo okupues si Serbia. Ju e dini shumë mirë historinë e Ballkanit. Veproni drejt me konventat ndërkombëtare,

sepse çdo proces ka vijat e kuqe dhe dikur mund të na humbë durimi.

Jemi një popull i lashtë dhe autokton në këtë Dardani. Po ju shohim se nuk jeni duke vepruar me drejtësinë dhe rregullat ndërkombëtare. Po mundoheni që Serbinë ta ngrehni në këmbë, që edhe një herë të bëjë krime ndaj popullit shqiptar, por kjo histori ka mbarur njëherë e përgjithmonë. Duhet ta dini ju, znj. Mogherini, se ne jemi faktor stabiliteti në Ballkan dhe në Evropë.

Po ju them se nuk do të ketë asnjëherë stabilizim politik ekonomik e social pa të drejtat e shqiptarëve. Këtë ju e dini mirë, andaj paraqiteni në sipërfaqe realitetin, se edhe ne jemi popull liridashës si ju dhe intelektualë.

Ne dëshirojmë të jemi të lirë si ju, pra të lëvizim lirshëm në të gjitha drejtimet dhe të kemi bashkëpunim me të gjitha shtetet fqinje, por në mënyrë reciproke. U bëj thirrje bizneseve tona të kenë durim, ta shtrëngojnë rripin dhe të punojnë më shumë për shtetin dhe lirinë e qytetarëve.

Përkrahi plotësisht kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, për vënien e taksës 100 për qind kundër produkteve serbe. Ky veprim është reciprok ndaj gjuhës dhe veprave të tyre. U munduam me dialog të merremi vesh që 20 vjet, por Serbia gjithmonë punon në mënyrë të hapur kundër Kosovës dhe këtë e di shumë mirë Evropa.

Jagxhillari në Bruksel prezanton sukseset dhe sfidat e administratës publike

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Ministri i Administratës Publike (MAP), Mahir Jagxhillar, po merr pjesë në konferencën e nivelit të lartë ministror për përmirësimet në administratën publike nëpërmjet bashkëpunimit rajonal e cila është organizuar nga Shkolla Rajonale për Administratë Publike (ReSPA). Në këtë konferencë, ministri Jagxhillar ka prezantuar në panelin ministror së bashku me kolegët e vet nga rajoni dhe Komisioni Evropian.

Në fjalimin e tij ai ka folur për prioritetet, zhvillimet si dhe sfidat në fushën e reformave të administratës publike, me theks të veçantë për përparimin e arritur në administratën publike në Kosovë sa iu përket politikave, legjislacionit dhe dokumenteve

strategjike. Jagxhillari ka folur edhe për sukseset e Qeverisë, duke bërë me dije se në vitin 2018 Qeveria e Kosovës ka votuar pakon ligjore gjithëpërfshirëse për reformën e administratës publike e cila përmban tri ligje të rëndësishme, si: Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, Ligjin për zyrtarët publikë dhe Ligjin për pagat në sektorin publik të cilat janë votuar në parim nga Kuvendi i Kosovës.

Më tutje, ai ka folur edhe për digjitalizimin e shërbimeve publike si dhe ka shpalosur arritjet e Kosovës në këtë fushë. Ministri Jagxhillar ka thënë se ReSPA vazhdon të jetë partner i rëndësishëm për modernizimin e administratës publike në Kosovë.



Dorëzohet medikamenti 'Surfaktant' në Klinikën e Neonatologjisë

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Në Klinikën e Neonatologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës u bë dorëzimi i medikamentit jetëshpëtues 'Surfaktant', donacion ky i bërë i mundshëm përmes bashkëpunimit të suksesshëm

dhe të vazhdueshëm në mes të "Aksionit për Nënën për Fëmijë" dhe organizatës ndërkombëtare "AmeriCares". Më shumë se 240 shishe të medikamentit janë dorëzuar si donacion, sasi kjo e cila do ta mbulojë nevojën vjetore të furnizimit

me 'Surfaktant'. Foshnjat që përjetojnë probleme të frymëmarrjes kanë mungesë të 'Surfaktantit' - shtresë e lëngshme brenda mushkërive dhe foshnjat zakonisht nuk fillojnë prodhimin surfaktantit deri disa javë pas lindjes.



Në Maqedoni shënohet Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka urrear shqiptarët për 22 nëntorin, Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, duke theksuar se sot është një ditë e rëndësishme për shqiptarët në Maqedoni dhe për të gjithë shqiptarët anembanë botës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

SHKUP, 22 NËNTOR - Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, 22 Nëntori, në Maqedoni është festë shtetërore për shqiptarët, ndërkaq gjuha shqipe në Kushtetutën e Maqedonisë është definuar si gjuhë që e flasin 20 për qind e popullsisë në vend. Por, Ligji i gjuhëve, në bazë të të cilit parashihet zgjerimi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në institucionet e pushtit vendor dhe atij qendror, tetë muaj pas miratimit ende nuk arrin të hyjë në fuqi, pasi i njëjti mbetet i bllokuar për shkak të mosdekretimeve nga presidenti i

Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, edhe pse i njëjti dy herë mori vizë nga Kuvendi.

Në manifestimet e shumta organizuar me rastin e shënimit të festës së alfabetit nën përkujdesjen e dikasterit të eurointegrimeve në Maqedoni, krahas zyrtarëve të lartë të Maqedonisë, kanë marrë pjesë dhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, dhe ai Kosovës, Hashim Thaçi.

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka urrear shqiptarët për 22 Nëntorin, Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Ai ka thënë se sot është një ditë e rëndësishme për shqiptarët në Maqedoni dhe për të gjithë shqiptarët anembanë



botës. "Ditë kur para 110 vjetësh në Kongresin e Manastirit u arrit unifikimi i alfabetit me të cilin do

të shkruajnë, lexojnë dhe flasin të gjithë shqiptarët. Kjo ndihmoi në ngritjen e kulturës dhe arsimit shqiptar në një shkallë më lart, mirëpo, ishte edhe udhëkryqi në të cilin i gjithë potenciali intelektual i shqiptarëve, i tubuar në Manastir, duke i drejtuar sytë kah Perëndimi, e zgjodhi rrugën e përparimit", ka thënë Xhaferi. Lideri i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, ka urrear të gjithë shqiptarët për këtë ditë. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka postuar një fotografi duke bërë shqiponjën së bashku me presidentin Ilir Meta, kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, dhe zëvendëskryeministrin Bujar Osmani: "Gëzuar festën, miq! Devotshmëri e përjetshme ndaj idealit rilindës kombëtar, drejt

bashkimit, drejt komunitetit euroamerikan, drejt NATO-s dhe BE-së!", ka shkruar Ahmeti.

Në kuadër të Kongresit të Manastirit, i cili u zhvillua prej 14 deri 22 nëntorit të vitit 1908, morën pjesë 50 delegatë nga 26 qytete të ndryshme, klube dhe shoqata, me ç'rast u mor vendim që të pranohet alfabeti latin me disa ndryshime të shkronjave, duke i përshtatur ato për gjuhën shqipe.

Aktualisht në Muzeun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, objekt ky që përballlet me probleme të pronësisë, gjenden rreth 56 fotografi të pjesëmarrësve dhe 230 dokumente që i përkasin Kongresit të Manastirit mbajtur para 110 vjetësh, dokumente këto të ekspozuara në formë digjitale dhe në letër.



Haradinaj, mirënjohës KFOR-it për sigurinë

EPOKA
ERE

QENDRESA RAMA

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim komandantin e KFOR-it në Kosovë, Salvatore Cuoci, me të cilin ka biseduar për situatën e përgjithshme në vend dhe për proceset nëpër të cilat po kalon vendi. Ishte vlerësim i përbashkët se në Kosovë mbretëron një situatë e mirë e sigurisë.

Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar rolin e komandantit dhe të ushtarëve të KFOR-it për angazhimin e tyre për Kosovën dhe popullin e saj, duke i falënderuar ata për kontributin e tyre për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë. "Nën udhëheqjen tuaj KFOR-i ka dhënë kontribut për krijimin e një klime të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. Për këtë ju jemi mirënjohës si vend dhe si popull", ka thënë kryeministri

Haradinaj.

Haradinaj ka vlerësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe KFOR-it, në proceset zhvillimore të vendit, duke veçuar bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) si një forcë profesionale, shumetnike dhe gjithëpërfshirëse. Për rolin konstruktiv në krye të KFOR-it dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, kryeministri Haradinaj e ka nderuar komandantin e KFOR-it, Salvatore Cuoci, me "Hartën e Artë të Kosovës".

Ndërkaq komandanti i KFOR-it në Kosovë, Salvatore Cuoci, i ka prezantuar kryeministrin Haradinaj të arriturat e ushtrimit "Shpata e Argjendtë", ushtrim ky që organizohet nga KFOR-i dhe përfshinë të gjitha institucionet vendore të sigurisë dhe ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen, duke vlerësuar bashkëpunimin e mirë me të gjitha institucionet vendore, veçmas me ato të sigurisë.



BQK-ja nënshkruan marrëveshje me Bankën Qendrore Evropiane

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Bankën

Qendrore Evropiane (BQE). Me anë të kësaj marrëveshje pritet të thellohet bashkëpunimi ndërmjet bankave pjesëmar-

rëse në shkëmbimin e informatave. Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije se deri më tani Kosova

është vendi i vetëm që ka arritur të nënshkruajë marrëveshje të tillë me Bankën Qendrore Evropiane.



Lugina kërkon përjashtimin e bizneseve të shqiptarëve nga taksa doganore



PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, është pritur të enjten në takim nga zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj. Në këtë takim Mustafa dhe Limaj kanë diskutuar për situatën politike në Luginë të Preshevës dhe për procesin e

aktiviteteve rreth bashkimit të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Republikën e Kosovës. Sipas Mustafës, është trajtuar edhe taksa prej 100 përqindësh ndaj produkteve serbe që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës dhe reflektimi i saj te bizneset shqiptare në Luginë. Ai e ka

përgëzuar Kosovën për këtë vendim i cili, sipas Mustafës, do ta vetëdijesojë Serbinë. Ai ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të shqyrtojë këtë masë tatimore për bizneset shqiptare nga Lugina. "Në të ardhmen e afërt Qeveria e Republikës së Kosovës do të shqyrtojë këtë masë tatimore

për bizneset shqiptare nga Lugina. Limaj ka disponim të konsiderueshëm, të cilin besojmë se e ka edhe Qeveria, për të gjetur një zgjidhje për bizneset shqiptare nga Lugina edhe ashtu të diskriminuara nga pushteti serb, duke e lehtësuar, përkatësisht shfuqizuar në tërësi masën tatimore

doganore. Një vendim i Qeverisë së Kosovës karshi fqinjit të saj Serbisë në lidhje me qarkullimin e mallrave është sa i drejtë, po aq burrëror dhe trimëror. Përgëzime për vendimin i cili do ta vetëdijesojë Serbinë se Kosova është shtet në vete", ka thënë Ragmi Mustafa pas takimit me Limajn.

Drejtori i ATK-së merr pjesë në konferencën ndërkombëtare në Budapest

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare profesionale dhe akademike, me temë "Siguria, shërbimi dhe zhvillimi - drejtimet e reja në operimin e administratave të të hyrave", e cila po mbahet në Budapest të Hungarisë. Qëllimi i kësaj konference është

diskutimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave, menaxhimi i të dhënave si mjet për lehtësimin e shërbimeve për tatimpaguesit, si dhe menaxhimi i të dhënave në luftën kundër mashtrimit, sigurimit të mjedisit afarist dhe auditimit të bazuar në të dhëna. Në këtë konferencë po marrin pjesë 14 shtete pjesëmarrëse nga IOTA, OLAF dhe Universiteti Kombëtar për Shërbime Publike i Hungarisë.



Kosova e vendosur që mos ta shfuqizojë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, pavarësisht prej presionit të BE-së për ta shfuqizuar taksën doganore 100 për qind ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjës, ka bërë me dije të enjten se kjo taksë nuk do të shfuqizohet. Kjo taksë e vendosur nga Qeveria e Kosovës ka marrë përkrahjen e komunitetit të biznesit

thirrje që kjo taksë të hiqet menjëherë pasi përbën shkelje të marrëveshjes së tregtisë së lirë, e njohur si CEFTA.

Zëdhënësja e përfaqësueses së lartë të BE-së, Maja Kocijanciq, ka thënë se Brukseli ka të drejtë të kërkojë nga Kosova ta shfuqizojë vendimin pasi "BE-ja monitoron zbatimin e të gjitha angazhimeve të bëra nga partnerët në rajon si dhe marrëveshja e CEFTA-s është shtyllë e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor".

Kocijanciq ka theksuar se vendimi i Kosovës për taksën nuk është në frymën e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të cilën autoritetet në Prishtinë e kanë nënshkruar me Komisionin Evropian. "Serbia dhe Kosova janë ankuar shumë herë për atë që ndodh në marrëdhëniet midis tyre dhe ne e kemi theksuar se këto çështje rregullohen përmes dialogut, për të cilin BE-ja ende është e gatshme të ndihmojë" ka deklaruar Kocijanciq. Ajo ka kërkuar nga të dyja palët t'i ndalojnë provokimet e tilla dhe të përqendrohen në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve pa parakushte të mëtejshme.

Vënia e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës ka ndikuar në rritjen e çmimit të bukës në Kosovë. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, u ka bërë apel bizneseve që mos t'i rritin çmimet e produkteve të ndryshme. Dogana e Kosovës ka filluar zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Dogana të enjten ka kthyer mbrapa shumë kamionë për shkak se mallrat që kanë pasur nuk i janë referuar Kosovës si shtet.

OEK-u, KMDLNj-ja dhe OVLUÇK-ja përkrahin vendimin e Qeverisë për taksën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka mbajtur të enjten takim informues me biznese të sektorëve të ndryshëm, lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind ndaj importit të produkteve nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. "Duke lënë anash interesin ekonomik personal, komuniteti i biznesit përkrah bashkërisht vendimin qeveritar, duke i dhënë konsideratë më të lartë interesit të përgjithshëm shtetëror. Megjithatë, për t'ua lehtësuar sadopak veprimtarinë e tyre bizneseve, bizneset e prekura nga kjo taksë kërkojnë qartësim të afatit kohor të këtij vendimi dhe informim më të hollësishëm rreth proceseve përcjellëse. Për më shumë bizneset shprehin nevojën për koordinim më të mirë ndërinstucional për klasifikimin e brenëve ndërkombëtare, mallin që gjendet në depot doganore dhe politikave shtetërore për mbështetjen e prodhimeve vendore", është thënë në njoftimin e OEK-ut.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka përkrahur vendimin e Qeverisë për taksën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. KMDLNj-ja ka bërë thirrje që institucionet e

Kosovës nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ultimatumit për tërheqjen e kësaj takse, por sipas këtij këshilli institucionet e Kosovës duhet të shkojnë përtej këtyre masave ndaj Serbisë, duke e zbatuar reciprocitetin 100 për qind. "Institucionet e Kosovës duhet t'i pezullojnë bisedimet në afat të pacaktuar derisa Kosova të trajtohet nga BE-ja në bazë të atyre standardeve me të cilat po trajtohet Serbia dhe vendet e rajonit. Kosova nga BE-ja dhe disa burokratë të saj nuk po trajtohet si duhet, por në kundërshtim me të drejtat elementare të njeriut", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Edhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) e ka ftuar Qeverinë e Kosovës të mos lëkundet nga presionet për rritjen e taksës në 100 për qind për mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Nëpërmjet një komunikate për medie OVLUÇK-ja ka vlerësuar se kjo masë është e vonuar dhe Qeveria e Kosovës është dashur shumë më herët të marrë masa të tilla, kur dihet se Serbia asnjëherë nuk po i respekton marrëveshjet me Kosovën dhe me politikën e saj agresive është duke e dëmtuar Kosovën edhe në planin ndërkombëtar.

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se taksa ndaj importit të mallrave serbe nuk duhet të hiqet derisa Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës. Këtë deklaratë Haradinaj e bëri të enjten gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, ku u diskutua për politikën e jashtme të vendit. "Mendoj se masat që kemi vendosur ndaj prodhimeve që vijnë nga Serbia duhet të jenë të përhershme deri në njohje, derisa Serbia nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur dhe sovran nuk duhet ta heqim", ka thënë Haradinaj. Ai bëri thirrje të mos ketë tërheqje ndaj këtij vendimi edhe përkundër faktit se mund të ketë, siç tha, "lutje, përkrahje apo këshilla si kundërvlerë për këto masa".

Pasi doli nga seanca e Kuvendit, Haradinaj u tha gazetarëve se u ka shkruar letër ambasadorëve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe përfaqësueses së BE-së, Nataliya Apostolova, përmes së cilës i ka njoftuar me arsyt e vendosjes së taksës. "U kam shpjeguar faktet pse kemi ardhur deri te ky vendim në çka kemi bazuar. Është një vendim i Kosovës, sovranë në mbrojtje të interesit të vet, por është i argumentuar pse e bëjmë këtë, që kryesisht ndërlidhet me mosrespektimin e marrëdhënieve tregtare Kosovë - Serbi nga ana e

Serbisë, duke vënë bllokadë tarrifore për produktet tona, shtuar këtu edhe agresivitetin ndaj Kosovës", ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se Republika e Kosovës beson se dialogu i bazuar në vullnetin e mirë, respektin e ndërsjellë dhe besimin e mirë është e vetmja mënyrë për ta ndërtuar besimin midis shteteve dhe popujve, duke nxitur paqen afatgjatë, forcimin e stabilitetit rajonal dhe rritjen e prosperitetit. "Prandaj, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse afatgjatë të paqes me Serbinë, e cila adreson të gjitha çështjet politike, të sigurisë, ekonomike, tregtare dhe kulturore. Kosova ka zbatuar vazhdimisht dhe vendosmërisht dhe ka respektuar të gjitha detyrimet ndërkombëtare, duke përfshirë CEFTA-n dhe SAA-në e saj dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë. Qeveria e Kosovës u bënë thirrje përfaqësuesve të BE-së, si ndërmjetësues në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, ta detyrojnë Serbinë dhe Bosnje-Hercegovinën t'i përmbushin angazhimet e tyre sipas CEFTA-s dhe marrëveshjeve të tjera", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Deklarata e kryeministrit Haradinaj bëhet një ditë pasi Qeveria e Kosovës vendosi ta rrisë taksën doganore ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjës nga 10 për qind sa ishte deri tani, në 100 për qind. Bashkimi Evropian ka bërë



'Hortikultura' do të mbjellë 900 drunj dekorativë në kryeqytet

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER) - Ndërmarrja "Hortikultura" ka filluar të enjten mbjelljen e fidanëve dekorativë nëpër lagje të kryeqytetit si dhe nëpër oborre të institucioneve publike. Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se do të mbillen

900 drunj të rinj në oborre të shkollave, çerdheve, QMF-ve, në hapësirat publike në "Breg të Diellit", "Kalabri", "Lakrishte", "Dardani", "Ulpianë", "Rrugën B" si dhe në hapësira të institucioneve qeveritare.



Kryetari Haskuka prezanton Prizrenin në Paris

PRIZREN, 22 NËNTOR (ER) - Pas takimeve zyrtare, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka mbajtur një fjalë rasti në aktivitetin e organizuar nga Qendra Kulturore e Kosovës në Paris, në bashkëpunim me "Trashëgimia pa kufij" dhe Shoqatën "Albania". Në këtë ngjarje është promovuar edhe botimi i revistës kulturore "Art dhe trashëgimi" kushtuar Prizrenit. Të pranishëm në këtë

aktivitet kanë qenë profesorë, studentë dhe biznesmenë të mërgatës shqiptare, si dhe qytetarë të Francës, studiues dhe pjesëtarë të shoqërisë civile që kanë një interesim për Kosovën dhe Shqipërinë. Kryetari Haskuka ka folur për historinë dhe vlerat kulturore të Prizrenit si kryeqytet historik i shqiptarëve që bart në mozaikun e trashëgimisë së vet edhe kultura të tjera të larmishme të cilat

ia pasurojnë vlerat. Më tej, ai ka shpjeguar disa prej sfidave dhe punën e komunës për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit e cila ka vlerë sa materiale aq edhe shpirtërore. Në fund të aktivitetit, të pranishmit kanë shprehur dëshirën dhe interesin jo vetëm për ta vizituar Prizrenin, por edhe për të identifikuar dhe për t'i çuar përpara projektet e bashkëpunimit.

Komuna e Vushtrrisë pajiset me 4 500 kontejnerë për mbeturina

Vushtrri, 22 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se në bashkëpunim me GIZ-in gjerman kanë arritur t'i sigurojnë 4 500 kontejnerë për hedhjen e mbeturinave. Ai ka treguar se komuna dhe komi-

sioni komunal, bashkë me këshillat e fshatrave, do ta bëjnë shpërndarjen e kontejnerëve në çdo fshat të Vushtrrisë. "Komuna ime është shtëpia ime. 4 500 kontejnerë për ekonominë familjare në Vushtrri, investimi i radhës i Komunës dhe GIZ

Gjerman për ambient të pastër. Komuna dhe komisioni komunal, bashkë me këshillat e fshatrave, do ta bëjnë shpërndarjen e kontejnerëve në çdo fshat të Vushtrrisë. I kam kërkuar komisionin e këshillave të fshatit që shpërndarja të jetë e drejtë dhe

pa dallim për asnjë qytetar. Lus qytetarët që munden apo që tashmë e kanë kontejnerin familjar t'i japin përparësi fqinjit të vet që nuk ka mundësi financiare për ta blerë kontejnerin", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".



Malisheva mbështet Programin Nacional për Rininë

MALISHEVË, 22 NËNTOR (ER) - Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, ka vizituar Komunën e Malishevës, ku është pritur në një takim zyrtar nga kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj, me ç'rast kanë nënshkruar marrëveshje


bashkëpunimi për realizimin e Programit Nacional për Rininë. Ky bashkëpunim ka për qëllim është asistimin e ndërsjellë për implementimin e Programit Nacional për Rininë si dhe aranzhimin e përbashkët të aktiviteteve që kanë për synim promovimin e diturisë,

kreativitetit kulturor dhe mendimin kritik dhe sportit. Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, ka thënë se për realizimin e këtij programi rol kyç kanë udhëheqësit komunalë, prandaj ka falënderuar kryetarin Begaj për mbështetjen e pakursyer të tij.

Latifi urdhëron inspektoratin që të largohen produktet serbe

RAHOVEC, 22 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka urdhëruar Inspektoratin e Komunës për të dalë në terren në mënyrë që të largohen produktet serbe me mbishkrime fyese, sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës. "Pres që konform

vendimit të gjitha këto produkte të largohen nga tregu në mënyrë që të respektohet shteti dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Aksioni ka filluar sot në mëngjes dhe do të vazhdojë deri në largimin e këtyre produkteve nga tregu", është shprehur kryetari Latifi.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE COVENTRY - PETERBOROUGH 3+ GRANADA - SPORTING GIJON GG LEVERKUSEN - STUTTGART 3+

Beqiri: Në Drenicë shkojmë për fitore



Superliga në futboll rikthehet pas një pushimi për shkak të ndeshjeve të Përfaqësues së Kosovës në Ligën e Kombeve. Sot (e premte) zhvillohen dy ndeshjet e javës së 16-të, ku takohen Drenica - Trepça '89 dhe Ferizaj - Prishtina

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Portieri i Trepçës '89, Arben Beqiri, ka thënë të enjten për "Epokën e re" se skuadra nga Mitrovica udhëton në Skenderaj për t'i marrë tri pikët nga ndeshja me Drenicën, e cila është e vlefshme për javën e 16 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Portieri Beqiri e lavdëron skuadrën kuqezi, por konfirmon se '89-shi është përgatitur mirë për të arritur deri te fitorja. "Gjatë pushimit kemi punuar maksimalisht për ndeshjen me Drenicën. Luajmë si mysafirë dhe synojmë fitore në këtë takim, që është mjaft i rëndësishëm për të dyja skuadrat, për faktin se të dy klubet gjendeni në një pozitë jo të mirë në tabelën e klasifikimit dhe pikët e këtij takimi do të ishin shumë të mirëseardhura. Drenica është ekip që duhet respektuar, sepse luan futboll mjaft të mirë, sidomos para shikuesve të vet, por e mira është se ne jemi të kompletuar

për këtë ndeshje", ka thënë Beqiri për gazetë. Drenica luan si skuadër vendëse dhe mesfushori Taulant Dajaku pret që kuqezinjtë t'u rikthehen rezultateve pozitive për faktin se në katër ndeshjet e fundit ka regjistruar katër humbje. "Do të jetë ndeshje e vështirë për ne pasi vijmë nga një moment i keq yni dhe luajmë ndaj një ekipi të fortë. Shpresojmë të kthehemi te rezultatet pozitive", ka thënë Dajaku.

Drenica pozicionohet në vendin e tetë me 18 pikë, kurse Trepça '89 renditet një pozitë më lart, me një pikë më shumë.

Thaqi: Ferizaj ekip i papërshtatshëm, por ne mendojmë vetëm për fitore

Mbrojtësi i Prishtinës, Armend Thaqi, ka paralajmëruar se Prishtina synon fitoren e nëntë me radhë në ndeshjen ndaj Ferizajt. "Edhe pse udhëtojmë te kundërshtari, i cili në ndeshjen e parë na kishte befasuar, këtë herë

nuk e mendojmë një gjë tilla, por mendojmë vetëm për tri pikët. Shkojmë vetëm për fitoren e nëntë të radhës, duke dashur ta mbyllim stinorin në mënyrën më të mirë të mundshme", ka thënë Thaqi për faqen zyrtare të klubit kryeqytetas.

Mbrojtësi Thaqi e ka vlerësuar Ferizajn skuadër të papërshtatshme dhe e ka lavdëruar edhe trajnerin e saj, Afrim Tovërlanin.

IPKO SUPERLIGA

Të premtën takohen:
Drenica - Trepça '89
Ferizaj - Prishtina

Të shtunën takohen:
Flamurtari - Llapi
Ballkani - Gjilani
KEK-u - Liria

Të dielën takohen: Drita - Feronikeli

SHKURT

Më 20 dhjetor manifestimi "Laureatët e Vitit"

Manifestimi tradicional i Federatës së Futbollit të Kosovës "Laureatët e Vitit 2018" sivjet do të mbahet para festave të fundvitit. Komiteti Ekzekutiv i FFK-së në mbledhjen e fundit e ka caktuar komisionin për organizimin e këtij manifestimi, i cili është vendosur të mbahet më 20 dhjetor. Edhe këtë vit ky manifestim do të mbledhë mysafirë të shumtë ndërsa, si zakonisht, do të shpërblehen më të dalluarit e vitit në futbollin e Kosovës.

Ibra pranon të rikthehet në Milan

"Italia Sport Mediaset" është e sigurt se Zlatan Ibrahimoviç do të rikthehet në Serinë A. Sipas medias italiane, AC Milan e ka bindur sulmuesin suedez t'i bashkohet për fazën e dytë të sezonit. Oferta që i ka bërë drejtori i kuqezinjve Leonardos është 2.2 milionë euro nga janari deri në fund të sezonit. Objektiv i kryesor i Ibrahimoviçit do të jetë ta ndihmojë Milanin të renditet mes katër më të mirëve në mënyrë që në sezonin e ardhshëm të luajë në Ligën e Kampioneve.

Istogu mëson kundërshtarin në Kupën Sfiduese

Të enjten është hedhur shorti për një të tetën e finales së Kupës Sfiduese (Challenge Cup) për hendbolliste. Pas suksesit historik, Istogu është kualifikuar në mesin e 16 skuadrave më të mira, ndërsa tashmë ka mësuar kundërshtarin e radhës. Istogu në të tetën e finales do të luajë me skuadrën spanjolle Rincon Fertilidad Malaga. Ndeshja e parë luhet në Spanjë më 2-3 shkurt të vitit të ardhshëm, kurse e kthimit në Kosovë më 9-10 shkurt.

"Klan Kosova" - "Epoka e re", derbi i Media Ligës

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Një nga përballjet më interesante deri tash në Media Ligë do të zhvillohet sonte (e premte) nga ora 21:15. Dy ekipet më të mira në renditjen tabelore "Klan Kosova" dhe "Epoka e re" ndajnë "mejdantin" për pozitën e parë në tabelë, e cila aktualisht kryesohet nga "Epoka e re", me dy pikë më

shumë. Përveç dy pikëve më shumë, ekipi i "Epokës së re" ka sulmin dhe mbrojtjen më të mirë se kundërshtari, kurse vazhdon të jetë i vetmi ekip pa humbje në Media Ligë. Por, në rast se fiton "Klan Kosova", ky ekip renditet i pari në tabelë. Një ndeshje tjetër derbi do të zhvillohet në mes të "Lajmi.net"

dhe gazetës "Zëri", kurse ndeshje e fortë pritet të jetë edhe ajo në mes të "KosovaPress"-it dhe "Telegrafi"-t. Çiftet e tjera të javës së 11-të janë: "Gazeta Blic"- "InfoKosova & PrishtinaPost", "Kallxo.com"- "Media Works", "Gazeta Metro"- "D+", "RTK"- "Infokusi", "RTV Dukagjini"- "Ora Info".



Dajaku: Suksesi na bënë krenarë, por Kosova ishte favorite e grupit

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Mesfushori i Drenicës, Taulant Dajaku, ka vlerësuar suksesin e Përfaqësueses së Kosovës, duke thënë se "Dardanët" i kanë bërë të gjithë krenarë. Mirëpo mesfushori me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës

ka shprehur mendimin e tij se Kosova ishte favorite karshi skuadrave të tjera që në radhët e tyre kishin lojtarë joprofesionistë. "Ka qenë një zhvillim i madh pozitiv që sigurisht na bënë krenarë të gjithëve, por duhet të jemi racionalë në prit-

shmëritë pasi kompeticioni i Ligës së Kombeve na ka vënë në grup me ekipe që na bënte neve favorit për shkak se luanim ndaj ekipeve që kanë pak profesionistë në radhët e veta si, për shembull, Malta apo Ishujt Faroe. Duhet të jemi

krenarë, por jo të fillojmë të mendojmë se kështu do t'i vëmë në presion lojtarët tanë dhe pasi të vijë ndonjë humbje, do të bëjmë dramë. Ne duhet ta shijojmë suksesin muaj për muaj", ka thënë Dajaku për "Epokën e re".



Përurohet stadiumi në Shtime, ministri Gashi: U realizua një ëndërr e kamotshme

SHTIME, 22 NËNTOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, bashkë me kryetarin e Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka bërë sot përuarimin e stadiumit të Shtimes. Ky përuarim u bë në zbatim të memorandumit të nënshkruar mes MKRS-së dhe Komunës së Shtimes për investim financiar për ndërtimin e stadiumit. Vlera e realizimit të këtij projekti kalon shumë prej 100 mijë eurosh, të cilat janë financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në këtë përuarim morën pjesë edhe zëvendësiministri i Infrastrukturës, Fehmi Mujota dhe kryetari i klubit "Vjosa", Avdi Sadiku.



Ministri Kujtim Gashi shprehu falënderime për bashkatdhetarët dhe Komunën e Shtimes që me bashkëfinancim me MKRS-në kanë bërë të mundur realizimin e këtij projekti. "Është jashtëzakonisht një moment i veçantë për mua, për Qeverinë e Republikës së Kosovës, edhe për Komunën e Shtimes dhe qytetarët e saj që më në fund po e realizojmë një ëndërr të kamotshme të të gjithë sportistëve e sportdashësve që edhe Shtimja ta ketë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive, përkatësisht realizimin e sportit të futbollit", ka thënë ministri Gashi.

Ai foli edhe për sukseset e klubeve dhe sportistëve të Kosovës të të

gjitha sporteve që me pjesëmarrjen e tyre në gara evropiane e ndërkombëtare, Kosovës po i sjellin fitore e medalje të shumta. "Kjo natyrisht na bën të ndihemi mirë edhe neve për shkak se në vazhdimësi jemi duke krijuar edhe infrastrukturën e nevojshme për të gjitha llojet e sportit, në të njëjtën kohë jemi duke financuar jo vetëm sportistët, por edhe sportet, federatat dhe Komitetin Olimpik të Kosovës. Në vitin 2018, edhe në planifikimet për vitin 2019 kemi miliona euro të ndara për avancimin e infrastrukturës dhe mbështetjes së sporteve në Kosovë", ka shtuar Gashi.

Numri një i Ministrisë së Sportit u zotua se jo vetëm me këtë projekt që u përuarua sot, por shumë shpejt do të përfundohet edhe projekti i palestrës sportive. "Jam i gatshëm ta

mbështes edhe kërkesën e juaj që Shtimja të bëhet me qendër duke pasur parasysh një komunitet të madh të të rinjve të talentuar që ka Shtimja", përfundoi ministri Gashi. Ndërkaq kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka deklaruar: "Sot është nder për mua që me bashkëpunëtorët, bashkë me ministrin Gashi, të jemi këtu në promovimin e stadiumit të qytetit të Komunës së Shtimes, që është një nga projektet më të rëndësishme. Ky projekt nuk do të mund të realizohej pa një bashkëpunim dhe financim të përbashkët të komunës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Me theks të veçantë falënderoj bashkatdhetarët që kanë qenë iniciatorë të ndërtimit të stadiumit dhe ministrin për ndihmesën në vazhdimësi edhe në projekte të tjera".

Golden State pëson humbjen e katërt radhazi

Oakland, 22 nëntor - Vazhdon momenti negativ i skuadrës kampione të NBA-s, Golden State, pasi pësoi edhe një tjetër humbje nga Oklahoma (123-95). Kjo ishte humbja e katërt radhazi për këtë skuadër që vazhdon të vuajë nga mungesat e Curryt dhe Greenit. Për skuadrën fituese u dalluan Schroder me 32 pikë, George me 25, Adams me 20 pikë. Skuadra e Lakersit mundi 109-105 Clevelandin në fushën e këtij të fundit, një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund, me LeBron Jamesin që realizoi 32 pikë e 14 rebounde, duke mundur ish-skuadrën e tij. Në sekondat e fundit fiton edhe Houstoni, që mposhti 126-124 Detroitin, ndeshje e hapur deri në fund. Hardeni ishte shënuesi më i mirë për teksanët, duke realizuar 43 pikë, mbështetur nga Capela me 27 pikë e 15 rebounde si dhe Pauli me 15 pikë. New York mposhti Boston 117-109, ndeshje e dominuar nga miqtë, me Burke që e nisi ndeshjen nga stoli, por që ishte shënuesi më i mirë me



29 pikë. Për Celticsin u dallua Irvingu me 22 pikë e 13 asistime, por që mbetën për statistikë. Dy gjuajtje të lira të sakta nga ana e Marc Gasolit në sekondat e fundit i dhanë fitoren Memphisit, që mposhti 104-103 San Antonio. Conley me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë për Memphisit, duke i bërë të pavlefshme 24 pikët e DeRozan për Spursin.

REZULTATET

| | |
|----------------------------|---------|
| Charlotte - Indiana | 127-109 |
| Philadelphia - New Orleans | 121-120 |
| Atlanta - Toronto | 108-124 |
| Boston - New York | 109-117 |
| Chicago - Phoenix | 124-116 |
| Cleveland - Lakers | 105-109 |
| Houston - Detroit | 126-124 |
| Milwaukee - Portland | 143-100 |
| Minnesota - Denver | 101-103 |
| Dallas - Brooklyn | 119-113 |
| San Antonio - Memphis | 103-104 |
| Utah Jazz - Sacramento | 110-119 |
| Golden State - Oklahoma | 95-123 |

SHKURT

Ronaldo fiton 3 500 euro në orë

Revista e përjavshme italiane "Chi", e specializuar për kronikat rozë, ka analizuar disa prej lukseve të sulmuesit të Juventusit, Cristiano Ronaldos. Gjithçka fillon nga paga prej 31 milionë eurosh në sezon, e thënë ndryshe, 85 mijë euro në ditë ose 3 500 euro në orë. Këto shifra ia bëjnë më të lehtë Ronaldos plotësimin e dëshirave për makinat. Blerja e tij e fundit është një "Bugatti Chiron" me vlerë tre milionë euro. Ky është një automjet i rrallë, duke qenë se ekzistojnë vetëm 500 ekzemplarë.

Pensionohet Drogba

Ish-sulmuesi i Chelseat, Didier Drogba, ka bërë me dije se është tërhequr përfundimisht nga futbollit. "Kur mendoj për 20 vjetët e fundit të karrierës sime profesionale, duke parë këtë fotografi, mbi të gjitha si më ka formuar si njeri ky udhëtim. Nëse dikush të thotë se ëndrrat e tua janë tepër të mëdha, thjesht falënderoj dhe puno edhe më shumë, duke u treguar i zgjuar, për t'i kthyer ëndrrat në realitet", ka thënë Drogba, duke shtuar: "Falënderoj lojtarët, trajnerët, klubet dhe tifozët që ma kanë bërë këtë udhëtim kaq të këndshëm. Një faleminderit shumë të madhe dhe shumë dashuri për familjen time, skuadrën time personale që më ka mbështetur pa kushte gjatë gjithë karrierës. Uroj që Zoti të më bekojë po aq shumë për të ardhmen, sa ka bërë për karrierën time futbollistike". 40-vjeçari gjatë karrierës futbollistike ka luajtur për këto klube: Le Mans, Guingamp, Marseille, Chelsea, Shanghai Shenhua, Galatasaray, Chelsea, Montreal Impact, Phoenix Rising.

Casillas: Gabova që nuk u përballa me Mourinhon

Ish-portieri i Real Madridit, Iker Casillas, nuk kishte marrëdhënie të mirë me ish-trajnerin e tij, Jose Mourinhon, dhe tani spanjollit ka bërë me dije se ai është penduar që nuk ishte përballur drejt-përdrejt me trajnerin në atë kohë. Portieri e humbi vendin në formacion të parë në gjysmë të sezonin 2012/2013, kur në vend të tij filloi të luante Diego Lopez. "Ai u soll këtu për të garuar me Barcelonën dhe sollit me vete një situatë shumë të tensionuar që nxori në sipërfaqe madridizmin që nuk më pëlqeu asnjëherë. Ai e kaloi një limit me mua, por unë nuk e dëshirova kurrë një gjë të tillë. Viti i tretë nuk ishte aspak i mirë, edhe pse e fituam titullin e La Ligës, por kishte shumë njerëz me të cilët ishin shkatërruar marrëdhëniet. Nuk ishte një situatë e mirë as për të, as për mua e as për klubin", ka thënë Casillas. "Mendoj se nëse do të isha kthyer në kohë, do të isha përballur me Mourinhon. Por, atëherë, vendosa që të rri i heshtur dhe mendova se kjo ishte mënyra e vetme për t'i nderuar vlerat e Real Madridit", ka shtuar portieri Casillas.

Xavi: Guardiola mund t'i përsëritë sukseset e Barçës me Cityn

Ish-mesfushori i Barcelonës, Xavi Hernandez, është i bindur se ish-trajneri i tij, Pep Guardiola, i ka të gjitha mundësitë ta përsëritë suksesin e dikurshëm të Barcelonës me Manchester Cityn. "Pep vetëm do ta përmirësojë Manchester Cityn. Njerëzit u mahnitën se si fituan titullin sezonin e kaluar, por do të ketë më shumë tituj. Ai gjithmonë kërkon të përmirësojë, gjithmonë duke kërkuar më të mirën nga ekipi. Objektivi tjetër do të jetë Liga e Kampionëve dhe me atë unë mendoj se ata do ta bëjnë këtë. Ai ndërtoi diçka në Barcelonë që do të mbahet mend gjithmonë në historinë e futbollit. Ai mund të bëjë të njëjtën gjë edhe në Manchester. Manchester City po luan futboll të mrekullueshëm", ka thënë Xavi.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 22.11.2018

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, duke u bazuar në neni 12, pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e këtij vendi të lirë pune në Administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

Pozita: Sekretar i njësisë Akademike- 1 (një vende punë)

Numri i referencës : UHZ-së /020/18

Lloji i pozitës: I karrierës

Kategoria: D

Mbikëqyrësi drejtpërdrejt: Sekretari i Përgjithshëm

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Hartoni rregullore, udhëzime dhe rekomandime për njësinë përkatëse akademike, sipas udhëzimeve të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Menaxhmentit të UHZ-së;
- Përgatit format e vendimeve dhe kontratave për stafin e rregullt dhe me angazhim të njësisë përkatëse;
- Përgatit materialet për mbledhjet e organeve dhe komisioneve të njësisë përkatëse akademike dhe administrative, hartoni procesverbalin;
- Jep sqarime për dispozitat ligjore, për Statutin dhe aktet tjera normative të zbatueshme në Republikën e Kosovës për stafin e Njësisë Akademike dhe Administrative;
- Është bartës dhe mbikëqyrës i zyrës për çështje administrative të njësisë akademike, është përgjegjës që funksionet e caktuara të zyrës administrative të njësisë akademike të përmbushen në mënyrë efektive dhe efikase;
- Në koordinim me zyrtarët tjerë Administrativ të Njësisë Akademike hartoni planin e punës për vitin vijues;
- Sekretari i njësisë akademike përgjegjës për vlerësimin e punës për stafin administrative të njësisë akademike dhe përgatitjen e raportit vjetor të arritjes së objektivave;
- Kryen detyra tjera të kërkuara nga Sekretari i Përgjithshëm dhe në raste të caktuara edhe nga Dekani i Njësisë Akademike.

KËRKESAT / KUALIFIKIMET PROFESIONALE

- Të ketë diplomë universitare në më së paku katër (4) vite të studimeve ose Master nga fusha profesionale e drejtësisë të përcaktuar sipas nenit 225 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2.
- Të kenë së paku katër vite (4) vite provojë pune pas diplomimit, të dëshmuar me trust
- Të kenë dijeni të mjaftueshme në proceset arsimore dhe kërkimore;
- Të kenë aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxhuese;
- Duhet të ketë Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve të mëposhtme: MS Excel, MS Word;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo - shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11 paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, Rr. UÇK-së, p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës, zyra e protokollit. Formulari për aplikim mund të shkarkohet në (www.unhz.eu).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. Në procedurën e pranimit të kandidatëve do të bëhet testimi dhe intervista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Pejë, 2018



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 22.11.2018

Univerzitet "Haxhi Zeka" - Peç, baziran na osnovu člana 12, tačka 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova, Uredbe br. 02/2010 o postupcima Zapošljavanju u državnoj službi, Statutom Univerziteta "Haxhi Zeka" - Peç, objaviti :

KONKURS

Za popunjavanje ovih slobodnih radnih mesta u Administraciji Univerziteta " Haxhi Zeka" u Peç-i.

Položaj: Sekretar Akademске Jedinice-1 (jedna pozicija)

Referentni broj: UHZ / 020/18

Vrsta pozicije: karijera

Kategorija: D

Direktni nadzornik: Generalni Sekretar

ZADATAK I ODGOVORNOSTI

- izrađuje propise, smjernice i preporuke za odgovarajuću akademsku jedinicu, u skladu sa instrukcijama generalnog sekretara i rukovodstva UHZ-a;
- priprema oblike odluka i ugovora za redovno osoblje i angazovanje relevantne jedinice;
- Priprema materijale za sastanke organa i komisija odgovarajuće akademске i administrativne jedinice, sastavlja zapisnik;
- Obezbeđuje razjašnjenja o zakonskim odredbama, statutima i drugim normativnim aktima koji se primenjuju u Republici Kosovo osoblju Akademске i administrativne jedinice;
- je starješina i nadzornik kancelarije za administrativne poslove akademске jedinice, odgovoran je za efikasno i efikasno obavljanje funkcija administrativne kancelarije akademске jedinice;
- U koordinaciji sa drugim administrativnim službenicima akademске jedinice, izrađuje plan rada za narednu godinu;
- sekretar akademске jedinice odgovoran za ocjenjivanje rada akademskog osoblja akademске jedinice i priprema godišnjeg izvještaja o postizanju ciljeva;
- Obavlja druge dužnosti koje zahtijeva generalni sekretar i, u pojedinim slučajevima, dekan Akademске jedinice.

PROFESIONALNI ZAHTJEVI / KVALIFIKACIJE

- Da ima visoku stručnu spremu najmanje četiri (4) godine studiranja ili magistar stručnog pravosuđa određen članom 225. stav 2. podstavi 2.1 i 2.2.
- Imajte najmanje četiri godine (4) godina rada nakon diplomiranja, dokazano povjerenjem
- Da ima dovoljno znanja u obrazovnim i istraživačkim procesima;

- dokazali organizacione i upravljačke vještine;
- Trebalo bi da postoje odlična znanja o korišćenju sledećih aplikacija: MS Excel, MS Word;

OPĆE INFORMACIJE O KANDIDATIMA KOJI SE ODOSE NA PROCEDURE KONKURSA

Kosovska Civilna služba garantuje jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.

Ne - većina zajednice imaju pravo na pravično i proporcionalne zastupljenosti u organima državne službe centralne i lokalne javne uprave, kao što je navedeno u članu 11 stav 3 Zakona br.03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova.

Kompletna dokumentacija dostavlja se u rektoratu Univerziteta "Haxhi Zeka" - Peç, Ul. OVK. Bb, 30000 Peç, Republika Kosovo, u kancelariji za protokol.

Obrazac za prijavu možete preuzeti na (www.unhz.eu).

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objave u medijima.

Aplikacije dostavljene nakon roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Samo kandidati odabrani na kratkoj listi biće kontaktirani. Nakon testiranja, kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće pozvani na intervju.

Peçi, 2018

- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog suda;

Ime institucije: Opština Skenderaj – Direkcija za Finansije, Privredu i Razvoj.

Naziv radnog mesta: 1. Analista za budžet;

Broj izvršilaca 1

Budžetski kod: 17523

Funkcionalna kategorija: Profesional 2;

Stepen radnog mesta: Koeficionat 7;

Tip radnog mesta: Karijera, puno radno vreme 40 časova nedeljno;

Raportira: Direktoru DFPR-a;

Sedište: , Direkcija za Finansije, Privredu i Razvoj, opštine Skenderaj;

Opis radnih zadataka: Da osigurava da sve transakcije da registruju u registru knjigovodstva, da osigurava da sve primljene račune od budžetskih jedinica da predaju odmah za uplatu preko sistema blaga, rukovodi i nadzorava iskorišćenje svih budžetskih izvora, budžetska izveštavanja i nadziravanje svih budžetskih aspekata , Kontrolira troškove DFPR-a, saraduje sa sektorom za budžet i finansiranje, drži tačne podatke za primljene i potrošene fondove za DFPR-u, izvrši i druge zadatke po naređenju predpostavljeno.

Kvalifikacija: Stručna kvalifikacije, univesitetska diploma, najmanje 2 godina rdnog iskustva..

- Osim opštih uslova predviđene zakonom, kandidat mora ispuniti i sledeće uslove:
- Kratak CV;
- Da poseduje veštine i profesionalne sposobnosti za ovo radno mesto;
- Kandidat mora biti spreman da radi pod pritiskom na multietničkoj društvu;
- Dobre sposobnosti za komunikaciju;
- Poznavanje službenih jezika;
- Trajanje probnog rada je 12 meseci, na osnovu pravilnika MJA/DACZ br. 02/2011.

Zainteresovanih za ovo radno mesto, aplikaciji treba priložiti i sledeću dokumentaciju:

- Univesitetska diploma – Ekonomski Fakultet 2 godine radnog iskustva;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Rodeni izvod;
- Kopiju lične karte zdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog suda

Ime institucije: Opština Skenderaj – Direkcija za Javne Usluge.

Naziv radnog mesta: 1. Analista za budžet;

Broj izvršilaca 1

Budžetski kod: 18023

Funkcionalna kategorija: Profesional 2;

Stepen radnog mesta: Koeficionat 7;

Tip radnog mesta: Karijera, puno radno vreme 40 časova nedeljno;

Raportira: Rukovodiocu sektora za Javne Usluge – Direktoru Direkciji Javnih Usluga;

Sedište: , Direkcija za Finansije, Privredu i Razvoj, opštine Skenderaj;

Opis radnih zadataka: Da osigurava da sve transakcije da registruju u registru knjigovodstva, da osigurava da sve primljene račune od budžetskih jedinica da predaju odmah za uplatu preko sistema blaga, rukovodi i nadzorava iskorišćenje svih budžetskih izvora, budžetska izveštavanja i nadziravanje svih budžetskih aspekata , Kontrolira troškove DJU-a, saraduje sa sektorom za budžet i finansiranje, drži tačne podatke za primljene i potrošene fondove za DJU-u, izvrši i druge zadatke po naređenju predpostavljeno.

Kvalifikacija: Stručna kvalifikacije, univesitetska diploma, najmanje 2 godina rdnog iskustva..

- Osim opštih uslova predviđene zakonom, kandidat mora ispuniti i sledeće uslove:
- Kratak CV;
- Da poseduje veštine i profesionalne sposobnosti za ovo radno mesto;
- Kandidat mora biti spreman da radi pod pritiskom na multietničkoj društvu;
- Dobre sposobnosti za komunikaciju;
- Poznavanje službenih jezika;
- Trajanje probnog rada je 12 meseci, na osnovu pravilnika MJA/DACZ br. 02/2011.

Zainteresovanih za ovo radno mesto, aplikaciji treba priložiti i sledeću dokumentaciju:

- Univesitetska diploma – Ekonomski Fakultet 2 godine radnog iskustva;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Rodeni izvod;
- Kopiju lične karte zdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog suda

Ime institucije: Opština Skenderaj – Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje – Centar za Socijalni Rad .

Naziv radnog mesta: 1. Službenik za Socijalne Usluge;

Broj izvršilaca 1

Budžetski kod: 75611

Funkcionalna kategorija: Profesional 2;

Stepen radnog mesta: Koeficionat 6.5;

Tip radnog mesta: Karijera, puno radno vreme 40 časova nedeljno;

Raportira: Rukovodilaca Sektora za Socijalne Usluge u Centru za Socijalni Rad;

Sedište: , Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Blagostanje , opštine Skenderaj;

Opis radnih zadataka: Izvršava zaštitu dece, koji nemaju roditelje, usvojenje, porodično smeštavanje, privremeno starateljstvo za decu, preduzima potrebne mere u takvim slučajevima, radi u obnovu odnosa supruga i porodične., Podnosi predlog za verovanje u slučaju odvojenja supruga, prati realizaciju kotakata, prati slučajeve nasilja u porodici, zastiti žrtve krijumčarenja, i stara se za rehabilitaciju žrtava upotrebe narkotične substance, zaštita žrtava seksualnog nasilja, priprema dece i priprema porodice za adaptiranje tih deteta.

Kvalifikacija: Stručna kvalifikacije, univesitetska diploma, najmanje 2 godina rdnog iskustva..

- Osim opštih uslova predviđene zakonom, kandidat mora ispuniti i sledeće uslove:
- Kratak CV;
- Da poseduje veštine i profesionalne sposobnosti za ovo radno mesto;
- Kandidat mora biti spreman da radi pod pritiskom na multietničkoj društvu;
- Dobre sposobnosti za komunikaciju;
- Poznavanje službenih jezika;
- Trajanje probnog rada je 12 meseci, na osnovu pravilnika MJA/DACZ br. 02/2011.

Zainteresovanih za ovo radno mesto, aplikaciji treba priložiti i sledeću dokumentaciju:

- Univesitetska diploma – Fakultet Sociologije, Političke Nauke ili Psihologija, najmanje 2 godine radnog iskustva;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Rodeni izvod;
- Kopiju lične karte zdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog suda

“Civilna Sluzba Kosova je na usluzi svih stanovnika Kosova i poželjno očekuje aplikacije od muskaraca i žene od svih Zajednica Kosova” Aplikacije se mogu dobiti u CUG-u (Arhivi) br. 1, u prostorijama opštine Skenderaj. Kompletirana dokumentacija se predaje u CUG-u, opštine Skenderaj, u roku od 15 dana od dana objavljivanja ovog konkursa na javnim sredstvima informiranja i ueb stranicu opštine Skenderaj. Dokumentacija se ne vraća. Nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati Konkurs se objavlja na oba jezika.



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/1417

Më: 19.11.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, nenit 5 pika c,d të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues numër 08/2014, datë, 25.02.2014, neni 2 pika 1,2,4, dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS I BRENDSHEM

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

| Nr. | Niveli, Shkolla | Vendi | Titulli i punës | Koeficienti: 7.8 | Orë: në javë |
|-----|--------------------------------|----------|-----------------|------------------|--------------|
| 1 | SHFMU" Fehmi Agani" | Turjakë | Drejtor | 7.8 | 40 |
| 2 | SHFMU" Ismet Jashari-Kumanova" | Temeqinë | Drejtor | 7.8 | 40 |

Kualifikimet, shkathtësitë, aftësitë dhe përvoja:

- ✓ Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- ✓ Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitarë), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjor;
- ✓ Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- ✓ Të kenë përlunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
- ✓ Të ketë së paku 3 vjet përvojë punë në arsim ose në institucion të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente;

- Certifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Profolion profesional;
- Letërreferencë nga një institucion publik-kredibil(si Ministria e arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKAE, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë);
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuere për punën dhe angazhimet paraprake;
- Plani zhvillimor të institucionit edukativo-arsimorë dhe aftësues për të cilin ka konkuruar(së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12; Arial) sipas Udhëzimeve të MASHT;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është nën hetim.

Detyrat kyçe:

- Përpunon dhe koordinon lëndët, informatat, organizon ecurinë e punëve, takimeve ditore dhe prezantimeve dhe përpunon dokumentacionin e drejtpërdrejt që ka të bëjnë me procesin edukativo-arsimor;
- Kujdeset për komunikim me palët dhe për komunikim elektronik me akterët relevantë;
- Asiston në përgatitjen e dokumentacionit dhe materialeve të nevojshme të kërkuara nga i tërë personeli i shkollës, DKAE-së MASHT-it, si dhe për Bordin e shkollës;
- Bën kontrollimin profesional të cilësisë mësimore, organizative në të gjitha nivelet arsimore në bashkëpunim me trupat e tjera të institucionit, DKAE së, MASHT-it;
- Drejtori i shkollës të punojë së bashku me stafin dhe shërbimet tjera që të sigurojë arsim cilësor për të gjithë nxënësit;
- Drejtori i shkollës, së bashku me Bordin e shkollës, këshillin e shkollës DKAE-në do të përgatitë dhe menaxhojnë autonominë financiare të shkollës sipas formulës së financimit;
- Të kryen punë dhe detyra tjera që i ngarkohen nga DKAE-ja dhe MASHT-i në interes për shkollën.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim;

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen;

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në zyrën e pritjes së palëve në KK- Malishevë ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit nga data: 20.11.2018 , dita e fundit për dorëzim të aplikacioneve është: 27.11.2018

Orari i intervistimit do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Drejtorisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK) - Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK) Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerziteteski Kliniçki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosova
Sektori i Personelit

Në bazë të nenit 8, parag. 1 e 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik; nenit 10 dhe 13, paragrafi 5 i Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, (SHSKUK); nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; nenit 12, 13 dhe 16 të Statutit të QKUK-së; nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016, Vendimit nr. 47 dt: 12.01.2018, të Bordit Drejtues të SHSKUK-së; Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së publikon:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Njësisë Përbërëse Organizative të QKUK si në vijim:

1. Drejtor i Klinikës Obstetrike dhe Gjinekologjisë;

Koeficienti i pagës: (10.80)
Raporton: Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së
Orari i punës: I plotë
Kontrata: tri (3) vite me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat
Nr. i Referencës: SHSKUK - QKUK 43/2018-11/1

Kërkesat e përgjithshme për detyrën:

- Udhëheq me punët operative dhe administrative të Njësisë Organizative të QKUK-së;
- Koordinon aktivitetet e gjithëmbarshme shëndetësore, financiare dhe administrative të njësisë organizative të QKUK-së;
- Monitoron performancën profesionale dhe afarizmin financiar të njësisë organizative të QKUK-së;
- Mbikëqyr zbatimin e përzgjedhjes së shefave dhe stafit tjetër menaxhues të njësisë organizative të QKUK-së, në bazë të Konkursit Publik të shpallur në pajtim me ligjin si dhe statutin e QKUK;
- Siguron transparencën ligjore të punës dhe veprimtarisë së njësisë organizative të QKUK-së;
- Përgatitë për Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK raporte të rregullta pune (javore, mujore, tre dhe 6 mujore si dhe raportin vjetor);
- Përgatitë për Drejtorin e Përgjithshëm raportet periodike mujore me deklaratën përcjellëse financiare;
- Merr pjesë në mënyrë obligative në Bordin e Drejtorëve të QKUK-së;
- Përgatitë raporte plotësuese mbi aktivitetet e njësisë organizative të QKUK-së me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK;
- Përgatitë raporte të tjera analitike me rendësi, në pajtim me ligjin;
- Ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit për Shëndetësi, Statutit të QKUK-së dhe të SHSKUK-së si dhe të Rregullores të Brendshme;
- Bën vlerësimin e performancës individuale të të gjithë stafit menaxhial të njësisë Organizative të QKUK-së;
- Përgatitë raporte specifike sipas kërkesave për Bordin Drejtues, Ministrin e Shëndetësisë apo Qeverinë e Republikës dhe i procedon ato përmes Drejtorit të Përgjithshëm;

Detyrat kryesore

- Siguron udhëheqje efektive dhe efikase të Njësisë organizative të QKUK-së të cilën e menaxhon;
- Zbaton politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe SHSKUK-së përkitazi me Njësinë organizative të cilën e menaxhon;
- Ofton alternativa, udhëzime dhe orientime strategjike të zhvillimit në Njësinë organizative të QKUK-së të cilën e menaxhon;
- Siguron funksionimin e strukturës efikase menaxhuese brenda institucionit dhe në mënyrë të qartë identifikon nivelet e përgjegjësisë dhe obligimet brenda institucionit;
- Siguron zhvillimin e të gjitha procedurave dhe politikave të domosdoshme administrative për menaxhimin efikas dhe efektiv në institucion;
- Siguron sistemin e rishikimit të brendshëm efektiv duke përfshirë ankesat dhe çështjet legale të bazuara në procedura ligjore, si dhe mundëson raportimin zyrtar të rezultateve;
- Siguron implementimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve përmirësuese nga raportet e pranuar nga mbikëqyrja e jashtme dhe e brendshme;
- Është nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të drejtorit dhe stafit nën menaxhimin e tij, implementimi i dokumenteve strategjike të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe Bordi Drejtues i SHSKUK si dhe raportimi përkitazi me to;
- Siguron procesin e revizionit efektiv në institucion dhe revizione periodike në mënyrë të vazhdueshme, ndan rezultatet, zbaton dhe mbikëqyr veprimet përmirësuese;
- Siguron përgatitjen e planit vjetor të biznesit, diskutimin e tij si dhe harmonizimin me Drejtorin e Përgjithshëm dhe përmes tij me Bordin Drejtues të SHSKUK;
- Siguron zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të biznesit të institucionit;
- Siguron se institucioni ka përgatitë strategjinë e shërbimit që pasqyron direktivat e strategjisë së përgjithshme shëndetësore të SHSKUK;
- Siguron zhvillimin e imazhit pozitiv të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit dhe ndërton raporte të mira me publikun dhe mediat;
- Siguron transparencë të funksionimit të institucionit, përgatitë, publikon dhe ndan me palët e interesuara raportet vjetore të punës së institucionit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
- Krijon kushte optimale për punë për stafin e institucionit dhe zhvillon programe konkrete për zhvillimin dhe avancimin profesional të tyre;
- Vlerësimi i performancës sipas legjislacionit në fuqi.

Shkollimi i kërkuar:

- Të ketë arsimim të lartë universitar, krahas kualifikimit specialistik, duhet të ketë thirrje akademike ose shkencore të lëmisë së caktuar;
- Në mungesë të kandidatëve me thirrje akademike ose shkencore, Drejtorët e Njësisë Organizative të QKUK-së zgjidhen nga radhët e specialistëve të lëmisë përkatëse;
- Përparësi me rastin e përzgjedhjes do të kanë kandidatët me kualifikime të veçanta në lëmin e menaxhimit shëndetësor;

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Pesë (5) apo më shumë vite eksperience pune profesionale në lëminë përkatës në sistemin shëndetësor;
- Shkathësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike;
- Njohja e mirë e sistemit shëndetësor dhe organizimit të punës së institucioneve të kujdesit shëndetësor;
- Njohuri e legjislacionit në përgjithësi dhe të atij të fushës së shëndetësisë në veçanti;
- Njohuri në fushën e menaxhimit të financave publike;
- Aftësi të mira komunikuese në të folur dhe në të shkruar,
- Aftësi për pune ekipore;
- Njohja e punës me kompjuter (Word, Excel etj);
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe përvoja menaxheriale paraqesin përparësi;
- Drejtorët e Klinikave dhe Shërbimeve Klinike do të jenë të punësuar me orar të plotë të punës.
- Diploma e fakultetit,
- Licenca e punës,
- Çertifikatën e Lindjes dhe
- Letërnjoftimin – fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit, Objekti i ri i Administratës në QKUK, nr. Tel. 038/512-667.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

3



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë

“Korporata Energjetike e Kosovës” KEK SH.A, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj NJOFTON palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Aplikacioni për licencim të furnizimit me energji elektrike, me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Licencimi i furnizimit me energji elektrike, i ndërmarrjes “Korporata Energjetike e Kosovës” KEK SH.A, përveç tjerash do të përmbajë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blej, shes, ri-shes, importoj dhe eksportoj energji elektrike.
- I licencuari ka të drejtë të shes energji konsumatorëve fundor, të faturoj dhe inkasoj të hyra për energjinë e shitur, si dhe të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve.

I licencuari mund të kryej aktivitetin e furnizimit me energji elektrike në pajtim me dispozitat e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh pune, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. “Dervish Rozhaja”, Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrehaj@ero-ks.org; Tel. 038247615/118.

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.
Rr. Sheshi Nënë tereza nr. 36
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK) - Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK) - Hospital and University Clinical Service of Kosovo (IUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Univerziteti Kliniçi Centar Kosova – University Clinical Center of Kosova
Kadrovska Sluzba

Prema členu 8 Zakona, tačka 1 i 2 o radu br. 03/L-212; član 4, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnog Sektoru; člana 10. i člana 13, tačka 5. Statuta Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK); kao i član 62, stav 6, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 12, 13 i 16 Stauta UKCK; Član 5, Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; Odluka br. 47 dana 12.01.2018, Upravnog Odbora UBKSK; Generalnog Direktora UBKSK, objavljuje

KONKURS

Institucije: Univerziteti Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Univerziteti Kliniçi Centar Kosova (UKCK)
Naziv radnog mesta: Direktor Organizacione jedinice UKCK i to:

1. Direktor Klinike za Akušerstvo i Ginekologija;

